



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT BE QENDRA

BE LAJME



Gusht 2020
EUC-numër 53/2020

KRYESIMI GJERMAN ME KËSHILLIN E BE-SË



Permbajtja e lajmeve:

Kryesimi gjerman me Këshillin e BE-së	1
Në fokusin e Parlamentit Evropian	2
Dimensioni parlamentar i kryesimit gjerman me BE-në	3
Zgjedhjet parlamentare në Kroaci	3
Seanca konstituive e Kuvendit	4
Korniza e propozuar e negociatave për RMV	5
Ndihma makro-financiare e BE-së për Maqedoninë e Veriut	5
Përgjigja evropiane për tu përballur me COVID-19	6
Komisioni Evropian ka nënshkruar marrëveshje për furnizimin e vaksinave kundër	7
Mbështetje evropiane në energjitë e rinovueshme	7
Janë lehtësuar rregullat për produktet me origjinë nga Ballkani Perëndimor	8
12 Gusht Dita Ndërkombëtare e Rinisë	8
Mësimdhënia ka filluar në shkollat në Gjermani	9
Kanale inovative të shitjes për bujqit francezë	9
Ndikimi i COVID-19 në konsumin dhe kursimet e familjeve	10
Rregulla të reja për makinat në Evropë	10
19 Gusht Dita Botërore e Humanitetit	11
Kalendari i BE-së / shtator 2020	11

Nën sloganin "Së bashku për Rimëkëmbjen e Evropës", Gjermania për të 13-tën herë kryeson me kryesi me Këshillin e BE-së, nga korriku deri në dhjetor 2020.

Gjermania mori kryesimin e BE nga Kroacia në një kohë të krizës së madhe globale shëndetësore. Qeveria federale gjermane do të punojë ngushtë me vendet anëtare të BE dhe partnerët Portugalinë dhe Slloveninë nga treshja kryesuese e BE-së.

Parimet udhëheqëse të kryesimit të Gjermanisë me Këshillin e BE-së: Tejkallimi i përhershëm i pandemisë COVID-19 dhe rimëkëmbje ekonomike të COVID-19, përmes heqjes graduale të kufizimeve në zonën Shengen, kthimit të proceseve të rregullta në një mënyrë të koordinuar në drejtim të mbrojtjes së kufijve të jashtëm, procedurave të vizave, heqjes së kufizimeve në lidhje me krizën, krijimit të kushteve për rimëkëmbje ekonomike graduale.

Një Evropë më e fortë dhe më inovative - duke ndërmarrë hapa për transformim digjital të përshpejtuar, të qëndrueshëm dhe të bazuar në vlera. Kryesimi do të jetë i përkushtuar ndaj politikës rregullative digjitale moderne në mënyrë që të mbështesë transformimin dixhital brenda politikës ekonomike në përputhje me rregullat e konkurrencës në një mënyrë shoqërore dhe të qëndrueshme.

Evropa e drejtë- zgjidhja e efekteve sociale të krizës, ruajtja e kohezionit social dhe promovimi i perspektivave afatgjata për të rinjtë. Programi thekson promovimin e barazisë midis femrave dhe meshkujve, merr parasysh interesat e personave me aftësi të kufizuara dhe promovon një shoqëri civile aktive.

Evropë e Qëndrueshme - kapërcimi i pasojave socio-ekonomike të pandemisë COVID-19 në një mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Prioritetet për arritjen e këtij qëllimi janë: politika ambicioze për mjedis jetësor dhe biodiversitet me një fokus në agjendën e OKB-së për vitin 2030 për zhvillim të qëndrueshëm dhe bujqësi.

Evropë e sigurt dhe vlera të përbashkëta - mbrojtja e vlerave të përbashkëta, të drejtave dhe lirive individuale është një nga postulatet e BE-së. Programi i kryesimit parashikon përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar përmes Partneritetit Evropian të Policisë dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis policisë, doganave dhe gjyqësisë.

Evropa e fortë në botë - BE ofron një kornizë të centralizuar për politikën e jashtme kombëtare, të sigurisë dhe të zhvillimit dhe merr përgjegjësi të veçantë për veprimin e jashtëm efektiv evropian. Gjermania do të presë dy samite të mëdha gjatë kryesimit të saj: BE-Afrikë dhe BE-Kinë.

Të rinjtë. Gjermania do të vazhdojë angazhimin e saj në mbështetje të bashkëpunimit rajonal, veçanërisht midis gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Për BE-në dhe Gjermaninë, vendet e Ballkanit Perëndimor janë një përparësi kryesore. "Ne po kërkojmë një perspektivë të besueshme për pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE." Afrimi i tyre me Bashkimin Evropian është në interes të rajonit dhe BE-së. "Jemi duke forcuar në mënyrë aktive negociatat e vazhdueshme Serbi-Malin e Zi dhe duke u përgatitur për fillimin e negociatave të pranimin me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut duke përgatitur një kornizë negociuese për këto dy vende, duke marrë parasysh metodologjinë e re të zgjerimit," - theksuar në programin e kryesimit të Gjermanisë me BE-në 2020.

<https://www.eu2020.de/eu2020-en>

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN



www.europarl.europa



Kancelarja gjermane Angela Merkel iu drejtua PE në debatin mbi strategjinë dhe qëllimet kryesore të Kryesimit Gjerman me Këshillin e BE

Rezultatet e një sondazhi të ri të opinionit publik COVID-19:

"Qytetarët evropianë presin që Bashkimi të tregojë solidaritet më të madh, të marrë më shumë masa për rimëkëmbjen." Në kontekstin e negociatave për buxhetin e ardhshëm të BE, Parlamenti bashkon kërkesat e qytetarëve për një Bashkim me ndikim dhe më ambicioz

Parlamenti mbajti seancë plenare plenare nga 8 deri më 10 korrik të këtij viti, në të cilën Kancelarja gjermane Angela Merkel prezantoi programin dhe përparësitë e Kryesimit Gjerman të Këshillit të BE. Eurodeputetët dhe Kryetarja e KE Ursula fon der Lajen morën pjesë në debatin mbi qëllimet e presidencës gjermane.

Eurodeputetët miratuan me 343 vota kandidaturën e Fransoa-Lui Mihaud për drejtor ekzekutiv të Trupit Mbikëqyrës Evropian Bankarë (EBA), i cili është pjesë e sistemit Evropian për Mbikëqyrje Financiare dhe paraqet një trup të pavarur i cili përgjigjet para PE, Këshillit dhe KE.

Në debatin me kryetarin e Këshillit Evropian Charl Mishel dhe Komisionerin Evropian Marosh Shefoviq, eurodeputetët riafirmuan që paketa e rinovimit dhe buxheti i rinovuar afatgjatë i BE i propozuar nga KE janë minimumi i pranueshëm nga Parlamenti Evropian. Eurodeputetët bënë thirrje për një plan të duhur ripagimi, duke përfshirë "burimet e veta të BE" të reja, burimet e të ardhurave si tatim digjital.

Lidhur me projekt-konkluzionet e Këshillit Evropian të 17-21 korrik, Parlamenti Evropian shprehu kënaqësinë me fondin e rimëkëmbjes, por jo me buxhetin e propozuar afatgjatë. Ekipi negociator i PE për kornizën financiare shumëvjeçare (2021-2027), i përbërë nga 6 eurodeputetë, mirëpriti kompromisin politik të udhëheqësve të BE dhe marrëveshjen mbi instrumentin e ri të rimëkëmbjes. Sidoqoftë, PE e ka bërë të qartë se ka vërejtje serioze për disa aspekte kryesore të kompromisit të arritur, veçanërisht nga një perspektivë afatgjatë. Deputetët e Evropës nuk ranë dakord për uljen e programeve të orientuara drejt së ardhmes dhe thanë "themelet e rimëkëmbjes së qëndrueshme dhe fleksibile do të minohen". PE nuk e pranon tavanin e propozuar rekord të ulët të buxhetit për programet e BE-së për Ndryshimet

Klimatike, Tranzicionin Digjital, shëndetësinë, rininë, kulturën, kërkimin ose menaxhimin e kufirit. Qytetarët evropianë kërkojnë solidaritet më të madh evropian, investime më të mëdha dhe masa në shëndetin publik, kërkime, digjitalizim, luftë kundër ndryshimeve klimatike. Deputetët e Evropës do të jenë të bashkuar për çështjen e buxhetit afatgjatë të BE-së, derisa të arrihet një marrëveshje e kënaqshme në negociatat midis Parlamentit Evropian dhe Këshillit, më së voni deri në fund të Tetorit, me qëllim të zbatimit të qetë të programeve të BE-së të vitit të ardhshëm.

Me 562 vota, PE miratoi një rezolutë që përcakton parimet e strategjisë së ardhshme të shëndetit publik të BE pas krizës COVID-19. Rezoluta kërkon krijimin e shpejtë të një mekanizmi evropian për t'iu përgjigjur krizës shëndetësore, nevojën për vaksina të përballueshme dhe terapinë COVID-19 dhe nevojën për testime urgjente të sistemeve shëndetësore të Shteteve Anëtare.

Parlamenti Evropian ka mbështetur rregullat e rishikuara për të përmirësuar kushtet e punës së shoferëve në mënyrë që të ndalojë shtrembërimet e konkurrencës në transportin rrugor. Eurodeputetët miratuan të tre aktet ligjore pa ndryshime, të cilat u pranuan nga ministrat e BE në prill të këtij viti.

Parlamenti Evropian, me 550 vota, miratoi rezolutë mbi udhëzimet e ardhshme të punësimit të BE dhe bëri thirrje për masa radikale për të zbutur efektet në punësim dhe shokun social të shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Eurodeputetët bënë thirrje që përfshirja sociale dhe mirëqenia njerëzore të jenë thelbësore në politikat ekonomike të BE-së, me përparësi të barabartë në qëllimet sociale, ekonomike dhe mjedisit jetësor.

www.europarl.europa

DIMENZIONI PARLAMENTAR I KRYESIMIT GJERMAN ME BE-në

Kryesimi e Këshillit të BE-së merret tradicionalisht nga një Shtet Anëtar i BE-së mbi një bazë rotacioni për një periudhë prej gjashtë muajsh. Përgjegjësia kryesore qëndron tek qeveria e vendit që merr Kryesimin, por në të njëjtën kohë ekziston dimensionin i mirënjohur Parlamentar i kryesimit të Këshillit të BE-së.

Parlamenti nacional i vendit që mban kryesimin e BE duhet të sigurojë bashkëpunimin ndërparlamentar dhe të forcojë rolin e parlamenteve nacionale brenda BE-së. Këto zona u zgjeruan nga Traktati i Lisbonës i cili hyri në fuqi në 1 Dhjetor 2009.

Parlamenti i kryesimit të BE-së duhet të thellojë dhe konsolidojë dialogun midis parlamenteve nacionale si dhe midis parlamenteve nacionale dhe Parlamentit Evropian. Për këtë qëllim, parlamenti organizon konferenca dhe ngjarje në të cilat fton parlamentet e vendeve anëtare të BE.

Në Republikën Federale të Gjermanisë ky rol luhet nga Bundestagu Gjerman si kryesor në organizimin e dimensionit parlamentar i cili vepron së bashku me Bundesrat i cili gjithashtu përfshihet në dimensionin parlamentar si dhoma e dytë në të cilën përfaqësohen shtetet federale ose Länder. Si edhe qeveria e vendi kryesues me BE-në, Parlamenti është një program i përbashkët me dy parlamentet tjera të të ashtuquajturës treshja presidenciale. Nga 1 korriku 2020 deri më 31 dhjetor 2021 Gjermania është pjesë e treshes presidenciale së bashku me Portugalinë dhe Slloveninë.

Më 29 qershor të këtij viti, Presidenti i Bundestagut Wolfgang Shojble (CDU) dhe Presidenti i Këshillit Federal (Bundesrat) Ditmar Voidke (SPD), së bashku me Kryetarin e Parlamentit të Portugalisë Eduardo Ferro Rodrigues dhe Pre-



sidenti i Asamblesë së Sllovenisë, Igor Zorçiç dhe Presidenti i Këshillit Nacional Slloven, Alojz Kovça, nënshkruan një Deklaratë të tre parlamenteve mbi dimensionin parlamentar të presidencës së Këshillit të BE.

Për shkak të pandemisë COVID-19, nënshkrimi u bë përmes video konferencës. Në Deklaratë, Kryetarët e tre parlamenteve ranë dakord të promovojnë Konferencën për të Ardhmen e Evropës.

Bundestagu do të organizojë tre takime për çështje të rëndësishme për anëtarët e Komitetit për Çështjet Evropiane: konferenca COVID 19 dhe si ta bëjmë Evropën më të fortë; konferencë mbi ndryshimin e klimës dhe politikën e përbashkët bujqësore të BE-së; konferencë kushtuar Evropës sociale.

<https://www.parleu2020.de/en/Events>

ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË KROACI

Në zgjedhjet parlamentare në Kroaci, të cilat u zhvilluan në 5 korrik të këtij viti, partia në pushtet Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ) i Kryeministrit aktual Andrej Plenkovi. Fituan 66 vende në Parlamentin Kroat. Aleanca e udhëhequr nga Partia Social Demokratike Liberale, partia kryesore e opozitës, fitoi 41 vende, ndërsa lëvizja e krahut të djathtë të Lëvizjes së Brendshme, e udhëhequr nga Miroslav Skoro, doli e treta me 16 vende. Parlamenti Kroat është i përbërë nga 151 anëtarë. Në Kroaci, 14 anëtarë zgjidhen në 10 zona elektorale, 3 në diasporë dhe anëtarët e pakicave zgjedhin 8 anëtarë të Parlamentit. Në listat e kandidatëve, gratë ishin të përfaqësuara me 41% dhe moshë mesatare e kandidatëve ishte 48.6 vjeç. Zgjedhjet u monitoruan nga rreth 8,700 vëzhgues dhe rreth 75,000 njerëz u punësuan për të kryer zgjedhjet. Zgjedhjet parlamentare të Kroacisë kishin një pjesëmarrje prej rreth 1.52 milion votues, ose 46% të votuesve të regjistruar, një pjesëmarrje rekord e ulët deri më tani. Kroacia është anëtare e Bashkimit Evropian që nga 1 qershori 2013.



<https://europeanwesternbalkans.com>

SEANCA KONSTITUTIVE E KUVENDIT



Seanca e parë konstitutive e përbërjes së dhjetë parlamentare të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbajt më 4 gusht të këtij viti në "Sallën e madhe" në vend të sallës "Maqedonia", nën protokoll të veçantë për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID – 19.

Në seancën të cilën e kryesonte Kryetari i mëparshëm i përbërjes parlamentare Talat Xhaferi, u zgjodh kryetari dhe anëtarët e Komisionit verifikues të Kuvendit, dhe u verifikuan mandatet e të gjithë 120 deputetëve.

Në përbërjen e dhjetë parlamentare të Kuvendit Koalicioni "Mundemi" i udhëhequr nga LSDM ka 46 mandate të deputetëve, Koalicioni "Ripërtërirja e Maqedonisë" e udhëhequr nga VMRO-DMPNE 44 mandate, BDI 15 mandate, koalicioni Alijanca e Shqiptarëve dhe Alternativa 12 deputetë, Levica 2 mandate dhe një Mandate PDSH-ja.

Në vazhdimin e seancën konstitutive që u mbajt më 21 gusht të këtij viti, deputeti Talat Xhaferi me 62 vota "për" dhe 43 "kundër", për herë të dytë u zgjodh Kryetar i Kuvendit.

Pasi që u zgjodh për Kryetar të Kuvendit, Xhaferi dha betimin solemn me të cilin menjëherë e mori funksionin.

Kuvendi në mbledhjen e mbajtur më 30 gusht të këtij viti me 62 vota "për" e zgjodhi qeverinë e re të koalicionit të LSDM dhe BDI, të udhëhequr nga kryeministri Zoran Zaev.



www.sobranie.mk

"Dua t'ju sigurojë se angazhimi im i ardhshëm në krye të institucionit ligjvënës, do të jetë në drejtim të njëjtë, megjithatë, i pasuruar me një përvojë më shumë, dhe me kushte më të ndryshme dhe më të volitshme për vendin tone, që sot është anëtar i Aleancës së NATO-s, me kornizën e miratuar të negociatave me Bashkimin Evropian për arritjen e anëtarësisë së plotë në familjen evropiane.

PROPOZIM KORNIZA NEGOCIEUSE PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Komisioni Evropian më 1 korrik të këtij viti në bazë të vendimit të Këshillit për Punë të Përgjithshme të BE-së nga 25 marsi i këtij viti, miratoi Propozim kornizën e negociatave për procesin e aderimit të Maqedonisë së Veriut. Dokumenti është në formë të propozimit dhe i njëjti është dorëzuar në Këshillin e BE-së, me qëllim të harmonizimit të tij dhe miratimit nga vendet anëtare të BE-së.

Komisari evropian për Politikë Fqinjësore dhe Zgjerim Oliver Varheri, theksoi “Duke e plotësuar obligimin tone, paraqesin korniza konkrete për ballafaqim të negociatave aderuese”. Propozimet tona themelohen në metodologjinë e reviduar për zgjerim që e prezantuar në shkurt që ta bëjmë procesin e aderimit më të besueshëm, me menaxhim më të fuqishëm politik, më dinamik dhe më të parashikueshëm”.

Propozim korniza negociuese i përcakton drejtimit dhe parimet e negociatave aderuese të vendit kandidat dhe është e koncipuar në 3 pjesë në bazë të Metodologjisë së re të procesit aderues:

1. Parimet sipas të cilave udhëhiqen negociatat aderuese,
2. esenca e negociatave dhe
3. procedurat e negociatave.

Propozim korniza negociuese për Republikën e Maqedonisë së Veriut është e bazuar në përvojën e zgjerimeve të mëparshme dhe negociatave rrjedhëse për aderim dhe e integron Metodologjinë e re për procesin e zgjerimit. Pasi që vendet anëtare të BE-së do të arrijnë pëlqim për kornizën e propozuar negociuese, kryesia e Këshillit të BE-së do ta prezantojë pozicionin e përgjithshëm të BE-së në konferencën e parë ndërqeveritare me vendet candidate. Konferenca ndërqeveritare do të paraqesë fillimin formal të negociatave për aderim në BE.

<https://ec.europa.eu>



NDIHMJA MAKROFINANCIARE E BE-SË PËR MAQEDONINË E VERIUT

Komisioni Evropian dhe Maqedonia e Veriut më 16 korrik të këtij viti nënshkroi Memorandum për mirëkuptim për ndihmë makrofinanciare prej 80 milionë euro. Ky është memorandum i parë i shkruar në kuadër të pakos për ndihmë makrofinanciare prej 3 miliadrë, i propozuar nga Komisioni Evropian sikurse për 10 vende të partneritetit nga procesi i zgjerimit dhe fqinjësisë së mirë me BE-në, me qëllim të përkufizimit të pasojave ekonomike nga pandemia me COVID-19. Vendimi për ndarjen e ndihmës makrofinanciare në kontekst të COVID-19 pandemia ishte propozuar nga ana e Komisionit më 22 prill dhe e miratuar nga ana e Parlamentit Evropian dhe 25 maj 2020. Mjetet do të jenë të arritshme si borxhe afatgjate me kushte të volitshme. меморандумот: зајакнување на фискалното управување и транспарентноста, борба против корупцијата, унапредување на надзорот над финансискиот sektor, унапредување на деловното опкружување, борба против невработеноста кај младите.

Programi për ndihmë makrofinanciare për vendin tonë është në vlerë prej 160 milionë euro. Mjetet do të kontribuojnë për përf forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe për zbutjen e pasojave socio-ekonomike të pandemisë.



Kusht për pagimin e trashës së dytë të mjeteve do të jetë zbatimi i politikave kontraktuese mes BE-së dhe Maqedonisë së Veriut të përmendura në memorandum: përforcimi i menaxhimit

fiskal dhe transparenca, lufta kundër korrupsionit, menaxhimi i mbikëqyrjes mbi sektorin financiar, menaxhimi i rrethimit afarist, lufta kundër papunësisë tek rinia.

<https://euractiv.rs>

MARRËVESHJA EVROPIANE PËR BALLAFAQIM ME COVID-19

EU #CORONAVIRUS
RESPONSE

Në takimin e ministrave të Shëndetësisë të 27-të vendeve anëtare të BE-së, më 13 shkurt të këtij viti në Bruksel u theksua nevoja për koordinim më të mirë të masave për luftë kundër zgjerimit të koronavirusit dhe problemeve me furnizimin e barërave dhe pajisjeve mediatike nga Kina. Ministrat unanimisht miratuan konkluzione me të cilat e përshëndetën "përgjigjen efikase të BE-së" të koronavirusit dhe i bënë thirrje vendeve anëtare që të ndërmarrin masa për përf forcimin e bashkëpunimit".

Kryetari i Këshillit Evropian, Sharll Mishell dhe kryetarja e Komisionit Evropian, Ursulla Fon der LLajen, më 21 prill e prezantoi [Заядничкиот патоказ за закрепнување](#) që i përcakton parimet e katër sferave kyçe për tekalimin e krizës.

1. tregu i plotë funksional dhe i vetëm i revitalizuar;
2. përf forcimi i të arriturave investuese;
3. veprim global dhe
4. sistem funksional i menaxhimit.

Komisioni Evropian më 27 maj të këtij viti prezantoi propozim për fondin për ripërtëritje dhe buxhet afatgjatë të BE-së, kornizë financiare afatgjate (MFF) për periudhën 2021-2027. Ministrat Evropian të Ekonomisë dhe Financave e theksuan rëndësinë që të sigurohet rimëkëmbje e qëndrueshme dhe arritje e qëllimeve të politikave të përbashkëta, si dhe për tranzicionin e gjelbër dhe digjital.

Ministrat e Shëndetësisë së BE-së më 12 qershor i shkëmbyen mendimet dhe e përshëndetën programin e ri të katërt të shëndetësisë së KE- EU4Health (2021-2027), të dizajnuar për të dhënë kontribut të dukshëm në rimëkëmbje pas COVID-19, me fokus të përf forcimit të elasticitetit të sistemeve shëndetësore dhe promovimin e inovacioneve në sektorin shëndetësor. Buxheti i programit të ri pritet të jetë rreth 25 herë më i madh se programi i deritanishëm shëndetësor i cili ishte rreth 450 milionë euro për 2014-2020.

Liderët e BE-së më 19 qershor biseduan përmes videokonferencës për buxhetin e BE-së për vitin 2021-2027 dhe planin për ripërtëritje me qëllim që të përgjigjen në krizën e shkaktuar nga COVID-19.

COVID-19 e theksoi nevojën për rol më të rëndësishëm të BE-së sfera e shëndetësisë – theksuan eurodeputetët në rezolutën e Strategjisë së ardhshme për shëndet publik të BE-së, me të cilën kërkuan krijim të shpejt të mekanizmave Evropiane për përgjigje të të gjitha llojeve të krizave shëndetësore përmes koordinimit më të mirë dhe menaxhimit me rezerva strategjike të barërave dhe pajisjeve mjekësore. Në debatin e strategjisë së ardhshme të BE-së për shëndet publik, në sesionin e korrikut të PE, eurodeputetët theksuan se janë të nevojshme vegla më të fuqishme për ballafaqim me gjendje të jashtëzakonshme shëndetësore. Për zhvillim, autorizim dhe qasje më të lehtë në vakcinat e sigurta kundër COVID-19, eurodeputetët me 505 vota për miratuan Rregullativë të re me procedurë urgjente, me të cilën do të mundësojnë zhvillim më të shpejtë të vaksinave dhe trajtim me COVID-19.

Më 6 maj të këtij viti përmes video lidhjeve u mbajt Samiti i Ballkanit Perëndimor në bashkë organizim të Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian në kuadër të Kryesimit kroat me BE-në. Liderët nënshkruan deklaratë të përbashkët me të cilën potencohet se BE-ja dhe vendet e Ballkanit perëndimor së bashku ballafaqohen me virusin korona dhe pasojat e pandemisë së COVID-19.

BE-ja mobilizon pako prej mbi 3,3 miliardë euro të dedikuara për vendet e Ballkanit perëndimor dhe shteteve fqinje të BE-së. Këto mjete, përpos rimëkëmbjes nga pandemia janë të dedikuara për përkrahje të drejtpërdrejtë për sektorin shëndetësor, për nevojat e rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike të vendeve të rajonit dhe shteteve fqinje të BE.

Përkrahje plotësuese siguron pako prej 750 milionë euro për ndihmë makrofinanciare dhe 1,7 miliardë euro nga Banka Investuese Evropiane.

Macro-Financial Assistance package

	Albania	€180 million		Moldova	€100 million
	Bosnia and Herzegovina	€250 million		Montenegro	€60 million
	Georgia	€150 million		North Macedonia	€160 million
	Jordan	€200 million		Tunisia	€600 million
	Kosovo	€100 million		Ukraine	€1.2 billion

KOMISIONI EVROPIAN NËNSHKRUAJ MARRËVESHJE PËR FURNIZIM TË VAKSINE KUNDËR COVID-19

Më 27 gusht hyri në fuqi marrëveshja për furnizim të vaksine kundër COVID-19, të cilën komisioni evropian e nënshkruaj me kompaninë farmaceutike britanike AstraZeneca. Me këtë marrëveshje KE siguron qasje më të lirë nga vaksina në vendet-anëtare, vendet partnere me të hyra më të ulëta, duke përfshirë edhe vendet nga Ballkani Perëndimor. Komisioni do të furnizojë 300 milionë doza nga vaksina të cilat duhet t'i prodhojë AstraZeneca, me mundësi për furnizim të edhe 100 milionë në emër të vendeve-anëtare të UE-së.

Vaksina e AstraZenec është në fazën e dytë dhe të tretë të testimit klinik.

Marrëveshja me AstraZeneca paraet hap i rëndësishëm në zbatimin e strategjisë Evropiane për vaksina, e miratuar nga Komisioni në 17 qershor këtë vit. Strategjia ka për qëllim të sigurojë vaksina kualitative, të sigurta, efektive dhe të kapshme në afat prej 12 deri në 18 muaj për të gjithë qytetarët evropian.

Së bashku me vendet-anëtare dhe Agjencia evropiane për barna, Komisioni do t'i shfrytëzojë kornizat ekzistuese fleksibile në kuadrin rregullativ të UE-së që ta përshpejtojë lejimin dhe kapshmërinë e vaksinave të suksesshme kundër COVID-19.

Më 6 shtator ishin dorëprerë testimet të vaksinës të kompanisë farmaceutike dhe universitetit Oksford në të gjitha vende në botë, me qëllim të mund të zbatohet hulumtim i pavarur për sëmundjen në praktikantin mbi të



Pasi që ishte kontrolluar gjendja dhe evidenca mjekësore e pacientit, shkencëtarët britanik kanë arritur në konkluzion se testimi mund sigurt të vazhdojë.

<https://ec.europa.eu>

PËRKRAHJE EVROPIANE TË ENERGJIVE TË RIPËRTËRISHME

Banka investuese evropiane (BIE) dhe UniKredit Austri investon 107,4 milionë euro për përkrahje të financimit të një nga fermat më të mëdha me energji me erë në Austri. Elektrana me erë do të ketë kapacitet prej 143 megavat dhe do të sigurojë rreth 90.000 amvisëri me energji elektrike të prodhuar nga burime të ripërtërishme. Projekti i cili përmban 26 turbina, fillojë këtë vjeshtë 2019, pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2021. Qëllimi i Austrisë është të sigurojë furnizim të plotë me energji elektrike nëpërmjet burime ripërtëritës deri në vitin 2030.

Objektin do ta drejtojë Grupacioni PÜSPÖK, biznes me seli në Burgenland i cili zhvillon dhe punon me ferma të prodhimit të rrymës me erë në Austri deri në fund të viti 1990.

Për momentin grupacioni furnizon 160.000 amvisëri në Austri me energji elektrike.

Financimi është i përkrahur nga Fondi Evropian për investime strategjike - shtylla kryesore e planit investues për Evropën. Projektet dhe kontratat të lejuara për financim sipas planit investues deri tash kanë mobilizuar rreth 524 miliardë euro në investime, prej të cilave rreth 84 miliardë euro për projekte të lidhura me energjinë.

Plani investues për Evropën është një nga aktivitetet kyçe të UE-së për përf forcim të investimeve në Evropë.

<https://ec.europa.eu>



RREGULLA TË LEHTËSUARA PËR PRODHIMET ME PREJARDHJE NGA BALLKANI PERËNDIMOR



Komisioni evropian më 24 gusht këtë vit miratoi pako të propozimeve të cilat kanë për qëllim ta zmadhojnë tregtinë ndërmjet Unionit Evropian dhe vendet fqinje të Pan-euro-rajonit mediteran (PEM), duke e përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor, me çka do të kontribuojnë për rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë me Covid-19.

Propozimet do t'i modernizojnë marrëveshjet preferenciale tregtare të UE-së me 20 partnerë për tregtim me PEM me atë që "rregullat për prejardhje" relevante në ato marrëveshje do t'i bëjnë më fleksibile dhe të volitshme për punë afariste, theksoi KE.

Këto propozime i ndryshojnë marrëveshjet bilaterale të UE-së me Maqedoninë, Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën.

<https://ec.europa.eu>

12 GUSHT - DITA NDËRKOMBËTARE E TË RINJVE



Dita ndërkombëtare e të rinjve 2020, në temën "Angazhim i të rinjve për veprim global" ka për qëllim t'i potencojë mënyrat nëpërmjet të cilave të njerëzit të rinj me angazhimin e tyre në nivel lokal, kombëtar dhe global i pasurojnë institucionet kombëtare dhe multilaterale dhe proceset.

Kuvendi i përgjithshëm i KB-së në vitin 1999, e lejoi rekomandimin nga Konferenca botërore të ministrave përgjegjës për të rinj (Lisbonë, 8-12 gusht 1998), 12 gushti shpallet për Ditë ndërkombëtare e të rinjve.

Përfshirja e të rinjve në mekanizmat formale politike e zmadhon drejtësinë të proceseve politike, kontribuon për politika më të mira dhe më të qëndrueshme, dhe kontribuon për kthimin e besimit të të rinjtë në institucionet publike.

Ndërtimi i kapaciteteve të të rinjve në miratimin e vendimeve dhe ndërmarrje të përgjegjësisë për shëndetin është element kyç i Programit botëror për aksion të të rinjve (WPAY). Roli i qeverive, organizatave të të rinjve dhe grupeve të bashkësisë do të jenë me rëndësi thelbësore në sigurimin e shpërndarjes së informatave të besueshme për shëndetin publik.

Inovatorët të rinj tashmë reagojnë në COVID-19 nëpërmjet inovacionit të ndikimit social. Në të gjithë botën zhvillohen numër i madh i iniciativave për shfrytëzimin e përpjekjeve të njerëzve të rinj për gjenerim dhe dhënie të përkrahjes së popullatës të prekur nga pandemia.

Me rastin e Ditës ndërkombëtare të të rinjve, Evrosat shpalli vegël interaktive për vizualizim „[Evropian të rinj](#)“ nëpërmjet të cilës të rinjtë prej 16 deri në 29 vjet mund të bëjnë marrëveshje me jetë e të rinjve të tjerë në vend dhe vende tjera anëtare të UE-së.

<https://ec.europa.eu>

FILLOJË MËSIMI NË SHKOLLAT NË GJERMANI

Në Meklenburg Pomerania Perëndimore, krahina federative e Detit Baltik më 3 gusht të këtij viti përsëri fillojë viti shkollor. Në 563 shkolla 152.700 nxënës nga e hëna deri të premtën duhet të kenë mësim "normal", më së paku katër ose pesë orë në ditë, theksohet në njoftimin e pushtetit krahinor të Meklenburg Pomerania Perëndimore.

Klasat duhet të ajrosen pas çdo ore. Parmakët nuk guxon të preken, ndërsa larja e duarve është obligim i çdo nxënësi. Mjetet për dezinfektim duhet të shfrytëzohen vetëm në raste të veçanta. Kuadri mësimor falas mund të testohet për COVID-19. Ardhja dhe shkuarja nga shkolla është më ndryshe e organizuar. Klasa e pestë dhe e gjatë formojnë një grup i cili mund të numërojë edhe deri në disa qindra nxënës. Ndër grupet të ndryshme nuk guxon të ketë kontakt, por brenda në to nuk ka të vlejë rregullat për distancë.

Çdo klasë ka hapësirë të saj në oborrin e shkollës, në gardërobë dhe kantinë. Nëse vjen te infektimi i fëmijëve vetëm një klasë do të jetë në karantinë, të tjerët vazhdojnë me mësim. Mënyrën e organizimit të mësimi e rekomandon edhe instituti Robert Koh si instanca më e lartë shëndetësore në vend.

"Mësimi plotësues "onlajn" në largësi, fillimisht shërben për ushtrime dhe përcaktim të shkallës," theksohet në Rregulloren e Ministrisë së Arsimit.

Dhjetë milionë euro nga Programi digjital i pushtetit federal gjerman janë dedikuar për bashkësitë lokale për furnizim të lloptëve dhe pajisje tjetër teknike.



Në krahinë rreth 2.000 mësues kaluan kurse nëpërmjet Interneti. Për atë qëllim, krahina bleu licencë nga startup kompania nga sfera e teknologjisë edukative (EdTech), e cila përfshin trajnim në onlajn didaktikë.

Katër ditë pas startit të vitit të ri shkollor, pushtetet shëndetësore në krahinë mbyllën dy shkolla për shkak të paraqitjes së rasteve të koronavirusit. Këshilli gjerman i prindërve dërgoi kritika te ministri gjerman për arsim dhe kolegët të tij resorjal nga krahinat gjermane për hapjes tepër të shpejtë dhe të pakujdesshme të shkollave, theksoi Shtefan Vasmuth, kryetar i Këshillit.

<https://euractiv.rs>

KANALE INOVATIVE TË SHITJES TË BUJQVE FRANCEZ

Mbyllja e tregjeve lokale gjatë kohës së pandemisë në qytetin Monpelje, kryeqyteti i rajonit francez Ero nuk e zvogëloi shitjen e prodhimeve të bujqve. Ata organizuan kanale të drejtpërdrejta të shitjes së prodhimeve të tyre deri te shfrytëzuesit përfundimtar.

Sistemi është i thjeshtë dhe praktik. Pas porositjes së kryer nëpërmjet interneti, klientët i ndërmorën prodhimet e tyre drejtpërdrejtë nga prodhuesit në punkte për shpërndarje të lejuara nga pushtetet komunale.

Struktura lokale organizative e formuar si përgjigje e dedikimit të kufizuar nga pandemia e COVID-19 i përforcoi zinxhirët e shkurtë lokal të furnizimit. Në organizatë ishin përfshirë edhe institucione siç janë dhomat bujqësore dhe pushtetet komunale të cilit qarkullonin lista të prodhimeve lokale dhe apelonin te publiku të kontaktojnë drejtpërdrejtë me bujqit.

Në hulumtimin e InPACT34 (Iniciativa për bujqësi qytetare dhe territoriale) e zbatuar në klientët të stacioneve të shpërndarjes, 147 persona kanë shprehur përgatitje të vazhdojnë ta shfrytëzojnë sistemin për furnizim në fqinjësinë e tyre.

Për dallim nga prodhuesit e perimeve, për shumë vreshtar dhe blegtor shitja e drejtpërdrejtë nëpërmjet kanaleve inovative, nuk qenka e mjaftueshme për kompensimin e humbjeve si rezultat i mbylljes së objekteve lokale të hotelierisë.



<https://www.euractiv.com>

NDIKIMI I COVID-19 MBI KONSUMIN DHE KURSIME TË AMVISËRIVE



Shkalla e kursimeve të amvisërive në BE shënoi rritje më të lartë vjetore në tremujorin e parë. Rritja e arritur 3,5% në lidhje me tremujorin e parë në vitin 2019. Arsyeja kryesore është ulja e shpenzimeve të konsumit të familjes (-1.7%) në krahasim me rritjet e fundit me mbi 2%. Rritja e të ardhurave bruto të disponueshme të familjeve (2.4%) gjithashtu kontribuuan në rritjen e shkallës së kursimeve.

Kursimet e familjeve rriten në të gjitha vendet anëtare të BE-së për të cilat ka të dhëna në dispozicion për tremujorin e parë të vitit 2020.

Rritje më të madhe u regjistrua në Slloveni (7.7%), e ndjekur nga Polonia (6.8%) dhe Spanja (6.7%). Rritje më të ulët shënon Suedia, (1,1%), Çekia (2%) dhe Gjermania (2,2%).

Rritja e shkallës së kursimeve të amvisërive shpjegohet me rritjen e të ardhurave bruto të disponueshme në të gjitha vendet anëtare të BE-së.

Ulje më të madhe të shpenzimeve për amvisëri është shënuar në Itali (-6,4%), Sllovenia (-5,3%) dhe Spanja (-5,2%). Nga ana tjetër, në gjashtë shtete anëtare të BE-së, konsumi individual i amvisërive po rritet në nivel vjetor, me rritjen më të lartë në Poloni (5.1%) dhe Çeki (4%).

Rënia e mprehtë dhe të paparashikuara të aktivitetit ekonomik që nga kriza me Covid-19 ka shkaktuar rënie dramatike të punësimin, numrit të vendeve të punës dhe orëve të punës. Rënia më e madhe është në fushën e dhënies së shërbimeve të akomodimit, transport, aktivitete të shërbimit ushqimor, art, argëtim, rekreacion etj veprimtari shërbimi, kryesisht industritë e prekura nga kriza, të cilat duhet të respektojnë rekomandimet dhe masat për parandalim përhapjen e koronavirusit.

<https://ec.europa.eu>

RREGULLA TË REJA PËR AUTOMJETET NË EVROPË



Nga 1 shtatori filloi zbatimin e Rregullat e BE për miratim dhe mbikëqyrje të tregut të punës së automjeteve motorike që u miratua në maj 2018. Rregullat e re e BE-së ka elementë kryesorë që forcojnë ndjeshëm sistemin e mëparshëm të miratimit dhe mbikëqyrjes së tregut, e përmirësojnë kualitetin dhe pavarësinë e miratimit të testimit të automjeteve, e rrisin kontrollin e automjeteve në tregun e BE-së dhe forcojnë sistemin e përgjithshëm me mbikëqyrje më të madhe evropiane.

Testimi dhe inspektimi i shërbimeve teknike të modeleve të reja të automjeteve do të rishikohen në mënyrë të pavarur në bazë të kriterëve të rrepta që të fitohet dhe mbahet niveli i emërimit

nga vendet anëtare. Korniza e re i përmirëson dhe kontrollin e automjeteve që veç më janë në treg dhe shiten nga auto shitës. Nga vendet anëtare kërkohet që rregullisht të testojnë numër minimal të automjeteve dhe të ndërmarrin masa paraprake mbrojtëse për automjetet që devijojnë nga rregullat në territorin e tyre. Në rastet kur prodhuesit i shkelin rregullat për miratimin e llojit (p.sh. deklarata të rreme), Komisioni mund të urdhërojë tërheqje në të gjithë territorin e BE-së dhe të vendosë gjoka për prodhuesit që shkojnë deri në 30,000 euro për makinë.

Kjo reformë në legjislacion është pjesë e angazhimit të Komisionit Evropian për sektor të pastër, të qëndrueshëm dhe konkurrues të automjeteve, siç është përcaktuar në komunikim „Evropa në lëvizje“. Iniciativa e Komisionit përfshin standarde për kualitet të ajrit dhe CO2, përmirësimin e testimit të emetimit për automjete ose përkrahje për lëndët djegëse alternative dhe prodhimin e baterive dhe konkurrencë në industrinë evropiane.

<https://ec.europa.eu>

19 GUSHTI DITA E HUMANIZMIT

Me rastin e Ditës Botërore të Humanizmit që shënohen më 19 gusht, sekretari i përgjithshëm i OKB Antonio Guterres u dha respekt të humanistëve, të "heronjve të vërtetë" dhe në luftën kundër pandemisë Covid-19. Me pandemia Covid-19 është rritur numri i njerëzve të cilëve i nevojitet ndihmë humanitare. Për shkak të kufizimeve të lëvizjes dhe karantinës të futur për të parandaluar përhapjen e virusit, shoqëria civile dhe organizatat lokale kanë marrë drejtimin në përgjigjen e krizës humanitare.

Më 18 gusht, në deklaratë me rastin e Ditës Botërore të Ndhmës Humanitare, përfaqësuesit e BE-së u dhanë nderim punëtorëve humanitarë të cilët ofruan ndihmë në kushte edhe më të vështira që nga shpërthimi i pandemisë së koronavirusit.



Komisioni Evropian do të financojë aksion humanitar në BE në shumë prej afër 10 miliardë euro gjatë shtatë viteve të ardhshme, siç njoftohet në deklaratën e përbashkët nga përfaqësuesi i lartë për Politikë të Jashtme dhe Sigurisë Zhozef Borel dhe komisar për menaxhim me kriza Janez Lenarčič. "Që të pengohen humbjet e tilla që të mbrohen punëtorët humanitar dhe civilët, është e nevojshmet të sigurohet respektimi i të drejtës ndërkombëtare humanitare. Prandaj i thërrasim të gjitha palët në konflikt të përmbahen nga sulme mbi infrastrukturën civile, duke përfshirë edhe shkollat dhe spitale", shtohet në njoftim.

Dita botërore e Humanizmit është themeluar në 2009 si komemoracion i përvjetorit të bombardimit të selisë së OKB në Bagdad, Irak në vitin 2003, kur u vranë 22 punëtorë humanitar.

OKB njoftoi se në vitin 2019 është shënuar numër rekord i sulmeve ndaj punëtorëve humanitarë, kurse cak i sulmeve kanë qenë edhe punëtorët shëndetësorë të cilët gjatë pandemisë janë ekspozuar ndaj rreziqeve edhe më të mëdha për shëndetin e tyre. Cak i sulmit ishin 483 punëtorë humanitarë, 125 u vranë, 234 u plagosën dhe 124 u rrëmbyen, ose 18% më shumë se në 2018. Vitin e kaluar është shënuar rritje e sulmeve ndaj punonjësve shëndetësor, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë ka pasur e 1.009 sulme ndaj punëtorëve shëndetësor dhe institucioneve, ku 199 njerëz kanë vdekur kurse 628 u plagosën.

<https://euractiv.rs>



UE KALENDAR / shtator 2020

1. Dy seanca plenare të Parlamentit Evropian: prej 31/08-03/09/2020 Bruksel, Belgjikë, dhe prej 14-17/09/2020 Strazbur, Francë;
2. Dita Evropiane e konkurrencës, 07-08/09/2020, Berlin, Gjermani;
3. Mbledhje e Këshillit për Punë të Përgjithshme të BE, 22/09/2020, Bruksel.
4. Mbledhje e Këshillit për Punë të Jashtme të BE, 24/09/2020, Bruksel.

European Union Newsroom

europa.eu

[EUROPA](#) > [Newsroom](#) > [Calendar](#)

[Home](#) [Highlights](#) [Press releases](#) [Calendar](#) [Audiovisual](#) [Press contacts](#) [Press facilities](#) [Subscription services](#) [About the EU](#)

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

September

Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat	Sun
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

Linqe dhe publikime elektronike të BE:

<https://publications.europa.eu/en/home>

<https://europa.eu/european-union/documents-publications>

<http://www.europarl.europa.eu/visiting/en/brussels/parlamentarium>



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokali 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me të përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.

Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të BE qendrës në Kuvend.

Qëllimi i formimit të BE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me BE çështjet.

BE qendra në mënyrë organizative është në kuadër të Sektorit për mbështetje të Këshillit Nacional për Eurointegritime

BE qendra disponon me bibliotekë me libra dhe publikime nga sfera të ndryshme të politikave evropiane.

